

STATUTI
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"MATIS CONSTRUCTION CHEMICALS" SHPK

Sot me date 03/05/2023 ortaku i vetem shoqerise si me poshte;

- **Durim Shehu**, i datelindjes 27.12.1964, lindur ne Tirane, dhe banues ne Rruga e Kavajes, identifikuar me karte identiteti me nr. personal G41227080C
- "**Ortaku i vete,n**", bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, themelon shoqerine sa me poshte vijon :

Kreu I
OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1. Objekti i shoqerise

1.1. Shoqeria ka kete objekt veprimtari:

Prodhimi, importi, shitja dhe shperndarja e produkteve te materialeve kimike te ndertimit, materiale termoizolimi te kombinuara, materiale hidroizoluese, dysheme industriale dhe bojra ne territorin e Shqiperise si dhe ne Kosove, Maqedoni, Mai i Zi, Serbi, Bosnje Hercegovine, Kroaci, Greqi, ose vende te tjera te cilat mund t'i caktoje ortaku i Shoqerise dhe shperndarja dhe shitja/eksporti i produkteve te materialeve kimike te ndertimit materiale termoizolimi te kombinuara, materiale hidroizoluese, dysheme industriale dhe bojra ne vendet e siperpermendura, shperndarja dhe shitja e produkteve te paleve te 2 treta ne vendet e siperpermendura dhe cdo veprimtari tjetër. Shoqeria do te kryeje veprimtarine ne perfitimin e vet dhe ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, ne baze te parimeve ekonomikesht te arsyeshme, fitimprures ne perputhje me standardet me te larta etike per te gjeneruar fitimin me te larte te mundshem per t'u shperndare mes Aksionareve..

1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajtshme dhe te paluajtshme, pjesmarrje ne kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

Neni 2. Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

- 2.1.** Ortaku vendosi qe shoqerine ta emertoje "**MATIS CONSTRUCTION CHEMICALS**" shpk.
- 2.2.** Selia kryesore juridike e Shoqerise ndodhet ne, *Tiranë, Bërxullë, RrugaFshati - Gjokaj, pasuria me numër 706/6 Z.Kadastrale 1167, Njësia Bashkiake Bërxull, Tiranë,*
- 2.3.** Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni.3. Regjimi Juridik

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.



3.2. Me vendim te tyre Ortaket mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise, n.q.s ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar.

Ne kete rast Ortaku do te pershtase Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te beje regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe ne perputhje me ligjin.

3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj.

Kreu II TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4. Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut te vetem.

4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj.

4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak apo aksionar ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj. Ajo ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e ortakut dhe as ky i fundit nuk mban pergjegjesi personale per detyrimet qe merr persiper shoqeria.

4.5. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.

4.6. Ortaket perballojne humbjet e shoqerise vetem dhe deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tij ne kapitalin themeltar.

Neni 5. Kohezgjatja

5.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te pacaktuar

Kreu III KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Kapitali themeltar eshte 100.000 (njqind mije) leke dhe eshte i ndare ne 1 kuote.

6.2. Ndarja e pjeseve ne kapitalin themeltar eshte :

- **Durim Shehu, 1 pjese, me vlere 100.000 (njqintemije) leke, e barazvlefshme me pjesemarrje ne perqindje ne masen 100% (njqinteperqinde).**

6.3. Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe do te marre asambleja e ortakeve.

6.4. Ky kapital nuk mund te jete me i vogel se minimumi i percaktuar me ligj.

Neni 7- Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar

7.1. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme midis ortakeve te shoqerise apo edhe kundrejt te treteve.

7.2. Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen, nga ortaket, personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e ortakeve te shoqerise.

7.3 Ne rastit e shume ortakeve, ortaket ekzistues gezojne te drejten e parablerjes, te kuotave ne shitje.

Kreu IV DREJTIMI DHE ORGANET KRYESORE

Neni 8

8.1. Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

8.2. Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, NIPT-i duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet dhe dokumentat qe nxjerr kjo shoqeri dhe ju drejtohen te treteve.

8.3. Organet kryesore te shoqerisa jane: Asambleja e Pergjithshme e perbere nga te gjithë ortaket e shoqerise dhe Administrator/i/et.

Neni 9

Asambleja e Pergjithshme e shoqerise

Asambleja e pergjithshem perbehet nga te gjithë ortaket e shoqerise dhe eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise dhe vendimet e tij jane te detyrueshme.

Te drejtat dhe detyrime t e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortaket. Te drejten e thirrjes se Asamblese e kane Administrator/i/et, Eksperti kontabel i autorizuar ose ortaket e shoqerise. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike.

Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se shtate dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamble nepermjet nje perfaqesuesi, duke qene i autorizuar me prokure te posacme, dhe te marrin vendime vetem per ato ceshtje qe diskutohen ne mbledhjen per te cilen ata kane marre te drejten e perfaqesimit.

Mbledhjet e asamblese pasqyrohen ne procesverbalin qe mbahet me kete rast, ndersa vendimet nenshkruhen nga ortaket e shoqerise.

Procesverbalet dhe vendimet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

Te gjitha vendimet e marra nga ortaket e shoqerise regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Ortaket e shoqerise kane te drejte te marrin vendime per ceshtjet e meposhtme:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) Ndryshimet e statutit.
- c) Emerimin e shkarkimin e administratoreve.
- ç) Emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar.
- d) Percaktimin e spherblimeve per personat e permendur ne shkronja "c" dhe "ç" te kesaj pike.
- dh) Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- ë) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- g) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- gj) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- h) Miratimin e regullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- i) Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Kreu V ADMINISTRIMI

Neni 10

10.1. Shoqeria do te administrohet nga 1 (Nje) administrator, i cili mund te zgjidhet edhe jashte ortakeve te shoqerise.

10.2. Administratori emerohet dhe shkarkohet nga Asambleja e ortakeve.

10.3. Administrimi i shoqerise do behet nga Administratori :

-z. Akrena Shehu .



10.4. Kohezgjatja ne detyre e administrator/it/eve te shoqerise do te jete 5 (pese) vjet me te drejte ripërteritje ne perfundim te mandatit.

10.5. Administrator/i/et i kane te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te shoqerise, me qellim arritjen e objektivave te saj.

10.6. Administrator/it/eve i takon firma/nenshkrimi e lire dhe perfaqesimi i shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seanca gjyqesore, arbitrazhi ose administrative.

10.7. Administrator/i/et jane pergjegjes, sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo deme te kryera gjate ushtrimit te detyres.

10.8. Kompetencat kryesore te administrator/it/eve ne shoqeri jane :

kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e ortakeve:

perfaqeson shoqerine tregtare.

kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise.

pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve i paraqet keto dokumente perpara ortakut te vetem per miratim.

krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.

kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit.

raporton perpara asamblese se ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.

kryen detyra te percaktuara ne ligj dhe statut.

administrimin e pasurise se Shoqerise, duke perfshire mjetet financiare, brenda caqeve te lejuara nga ortaku i vetem.

kryerjen e te gjitha veprimeve bankare ne interes te shoqerise.

te perfaqesoje Shoqerine me te tretet ne te gjitha veprimtarine e saj dhe te mbroje interesat e saj ne gjykate apo arbitrazh, nenshkrimin e kontratave ne emer te shoqerise dhe ndjekjen e zbatimit te tyre.

ti propozoje ortakut te vetem per miratim strukturen e aparatit te Shoqerise dhe krijimin e organeve te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te Shoqerise .

ti propozoje ortakut te vetem per miratim numrin e punonjesve te Shoqerise, pagat dhe emerimin e shkarkimin e tyre.

Kreu VI

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

Neni 11

11.1. Çdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare i cili fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit.

11.2. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht eksperti kontabel i autorizuar, miratohen nga ortakët e shoqerise.

11.3. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 12- Kontrolli i Shoqerise

12.1. Kontrolli i Shoqerise kryhet nga nje Ekspert Kontabel i Autorizuar, i emeruar nga ortakët e shoqerise.

12.2. Eksperti kontabel i autorizuar garanton qe llogarite vjetore te shoqerise jane te rregullta, te hartuara me sinqeritet dhe pasqyrojne rezultatet e vitit te kaluar financiar, si dhe gjendjen financiare te shoqerise. Ai verifikon librat e llogarive, si dhe fondet e shoqerise, kontrollon pershtatjen e

kontabilitetit me ligjin ne fuqi, verifikon perputhjen me llogarite vjetore te informacionit te dhe ne raportin e administrimit, kontrollon gjithë librat e llogarise, dokumentat kontabel dhe regjistrat e proces-verbaleve. Mund te aktivizojë eksperte dhe bashkepuntore per te perballuar volumin e punes, por duke marre me pare miratimin e ortakut te vetem.

12.3. Shkarkimi i Ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi nga ana e ortakeve.

Kreu VII PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 13

13.1. Shoqeria mund te priset ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkakut, si ne rast falimentimi, privim te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga Ortaket.

13.2. Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi, ortakët emerohen nje ose disa likujdatore, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetin te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

13.3. Ne fund te procesit te likujdimit, ortakët vendosin mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise se punes se likuduesit, dhe mbylljen e procesit te likujdimit.

13.4. Pas pagimit te kreditorëve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per ortakët e shoqerise.

Neni 14. Zgjidhja e mosmarrveshjeve

14.1.

Mosmarrveshjet midis ortakeve, shoqerise dhe te treteve ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Kreu VIII DISPOZITA TE FUNDIT


Neni 15

15.1. Per sa nuk eshte e parashikuar ne kete Statut, do t'i behet referim ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, si dhe legjislacionit koherent.

15.2. Ky statut hartohet ne 3 (tre) kopje, secila me te njejten vlere ligjore. Njera prej kopjeve ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

z. Durim Shehu



Tirane me : 03/05/2023